

VENDIM
Nr. 218, datë 21.3.2017

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA “POSTA SHQIPTARE” SHA
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TË PASURISË SË PALUAJTSHME ME
EMËRTIMIN “ZYRA BANKARE KLOS”, ME NR. 60, ME VENDNDODHJE NË ZONËN
KADASTRALE 2161, ME NUMËR PASURIE 1/144-N2(153), KATI I DYTË, DHE SIPËRFAQE
TË PËRGJITHSHME 210.1 M2, ME QËLLIM PAJISJEN ME NDËRTESESË TË SUBJEKTIT
“PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”, PËR DEGËN VENDORE TË PARTISË
SOCIALISTE KLOS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 22, shkronja “b”, e 22/1, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar, dhe të neneve 8, pika 3, 13 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga “Posta Shqiptare” sh.a., Ministrisë së Punëve të Brendshme, të pasurisë së paluajtshme me emërtimin “Zyra Bankare Klos”, me nr. 60, me vendndodhje në zonën kadastrale 2161, me numër pasurie 1/144-n2(153), kati i dytë, dhe sipërfaqe të përgjithshme 210.1 (dyqind e dhjetë pikë një) m2, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi, miratuar me vendimin nr. 363, datë 11.06.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi “Postës Shqiptare” sh.a.”, me qëllim pajisjen me ndërtesë të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për degën vendore të Partisë Socialiste Klos.

2. Prona e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në përgjegjësi administrimi të “Postës Shqiptare” sh.a., që i bashkëlidhet vendimit nr. 363, datë 11.6.2004, të Këshillit të Ministrave.

3. Ministri i Punëve të Brendshme të lidhë kontratën e huapërdorjes, sipas Kodit Civil, me subjektin “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në përputhje me shkronjën “b”, të nenit 22, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, të ndryshuar, për periudhën derisa partia politike plotëson kushtet e parashikuara në këtë nen.

4. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, drejtori i Përgjithshëm i Postës Shqiptare dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHITESHORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

A				B		C				
Nr.	Zona Kadastr. & Indeks i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statuti juridik i perdorimit	Te dhena te Fietra (Shena te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
59	2161	144 Nr.	Ndertese	Zyra Postare Klos (Qyteti Klos)	112	112	Sherbime Postare Financiare	Filiali i Postes Mat	Posta Shqiptare sh.a.	Objekti eshte ne katin e pare te nderteses 2 kt
60	2161	153	Ndertese	Zyra Bankare Klos	210.1	210.1	Sherbime Financiare	"	"	Objekti eshte ne katin e dyte te nderteses 2 kt kjo Ndertese eshte marr nga Banka
61	2161		Ndertese	Zyra Telefonike Qytet Klos	204	204	Sherbime telefonike	"	"	Objekti eshte ne katin e I te nje ndertese 2 kateshe

Institucioni i Pushtetit Qendror "Posta Shqiptare" sh.a.

Bashkia / Klos

Fusha e perdorimit te Prones: Sherbimeve Postare dhe Financiare

